



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 21 datë 06/03/1998

MBI

**FINANCIMIN NGA TE ARDHURAT E BASHKISE PER BLERJE
USHQIMESH, DRU ZJARRI, PAGESA TE ENERGJISE
ELEKTRIKE, UJI E SHPENZIME TE TJERA PER ÇERDHET E
FEMIJEVE.**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.06.03.1998, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mjedisit për financimin nga të ardhurat e Bashkisë për blerje ushqimesh, dru zjarri, të pagesës së energjisë elektrike, ujit, etj. për çerdhet e fëmijëve, në mbështetje të ligjit Nr.7572, dt.10.06.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal” dhe ligjit Nr.7776, dt.22.12.1993 “Për buxhetin lokal”

V E N D O S I

1. Dhënien nga të ardhurat e Bashkisë Drejtorisë së Qendrës Ekonomike të çerdheve të fondit për :
 - blerje ushqimesh, dru zjarri, pagesë energjie elektrike, uji, e shpenzime të tjera në vlerën **9.000.000** lekë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mjedisit, Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Qendrës Ekonomike të çerdheve.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI